ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **POLICIA E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-24-10564-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**"D & T Group" SH.P.K.**
NUI	**601666227**
Adresa	**Sadik Pozhegu / p.n.**
Vendi	**GJAKOVË**
Kodi postar	**50000**
Numri Telefonit	**044/420723**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Bledar Kusari**
Adresa elektronike	**dtgroupshpk@yahoo.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**06.01.2025**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në

Titulli i aktivitetit te prokurimit: FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në

Nr. i prokurimit: 214-24-10564-1-1-1

Autoriteti Kontraktues: POLICIA E KOSOVËS

B05 Njoftim per Kontrat: 08.11.2024

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara: 17.12.2024

Afati i fundit per dorezimin e tendereve: 30.12.2024

Kerkesa per rishqyrtim nga D&T Group SH.P.K.: 25.12.2024

Vendimi i A.K. mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim: 26.12.2024

Proces Verbali i Hapjes: 30.12.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kerkesa per rishqyrtim nga D&T Group SH.P.K.: 25.12.2024

Vendimi i A.K. mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim: 26.12.2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 – i LPP-së
Neni 5 - i LPP-së

Neni 6 - i LPP-së
Neni 7 - i LPP-së
Neni 28 - i LPP-së
Neni 60 - i LPP-së
Neni 104 - i LPP-së

Neni 19 - RREGULLORE NR.002/2024

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne D&T Group SH.P.K. ushtrojmë të drejtën tonë ligjore që permes Ankesës pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave ligjore nga ana e A.K. Policia e Kosovës në lidhje me aktivitetin e prokurimit FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në.

Pretendimi 1

Në mbështetje të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 ("Ligji i Prokurimit Publik"), theksojmë se ankesa mund të parashtrohet nga çfarëdo pale e interesuar në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit, për shkak të çfarëdo veprimi apo mosveprimi nga ana e Autoritetit Kontraktues, i cili supozohet të jetë në kundërshtim me dispozitat ligjore ose aktet nënligjore përkatëse.

Në pajtim me këtë bazë ligjore dhe konform nenit 5 të LPP-së, ne, D&T Group SH.P.K., më datën 25.12.2024, përmes sistemit të E-Prokurimit, paraqitëm kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues — Policia e Kosovës. Mirëpo, më datën 26.12.2024, Policia e Kosovës publikoi vendimin mbi refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim, duke e cilësuar atë si "të jashtë afatshme".

Ky veprim i Autoritetit Kontraktues bie ndesh me nenin 5 të Ligjit të Prokurimit Publik, ku ndër të tjera specifikohet qartë se:

"Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në ora 16:00 në ditën e skadimit. Të shtunat, të dielat dhe festat zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare, afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj."

Sikurse dihet, 25 dhjetori 2024 është festë zyrtare në Republikën e Kosovës dhe ditë pushimi për A.K. Policinë e Kosovës dhe institucionet tjera shtetërore. Për pasojë, çdo afat ligjor që parashihet të skadojë më 25.12.2024, duhet, sipas dispozitave të cituara, të zgjatet deri më datën e parë të punës pas kësaj date. Moszbatimi i kësaj norme përbën shkelje të qartë të rregullave për kalkulimin e afateve kohore, duke na privuar nga e drejta ligjore për kërkesë rishqyrtimi brenda afatit të lejuar.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Festat zyrtare në Republikën e Kosovës për vitin 2024
Službeni praznici u Republici Kosova za 2024 god.

Festat zyrtare në pajtim me nenin 2 të Ligjit Nr. 03/L-064, për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës, janë:
Službeni praznici u skladu sa članom 2. Zakona br.03/L-064, o Službenim praznicima u Republici Kosova, su:

Nr.	Festat Zyrtare Službenih praznici	Dita/Data e festës Dan/Datum praznika		Dita/Data e pushimi Dan/Datum odmora	
1.	Viti i Ri Nova godina	E hënë Ponedeljak E martë Utorak	1 janar 1 januar 2 janar 2 januar	E hënë Ponedeljak E martë Utorak	1 janar 1 januar 2 janar 2 januar
2.	Krishtlindjet ortodokse Pravoslavni Božić	E diel Nedelja	7 janar 7 januar	E hënë Ponedeljak	8 janar 8 januar
3.	Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës Dan Nezavisnosti Republike Kosova	E shtunë Subota	17 shkurt 17 februar	E Hënë Ponedeljak	19 shkurt 19 februar
4.	Pashkët Katolike Katolički Uskrs	E diel Nedelja	31 mars 31 mart	E hënë Ponedeljak	1 prill 1april
5.	Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës Dan Ustava Republike Kosova	E martë Utorak	9 prill 9 april	E martë Utorak	9 prill 9 april
6.	Bajrami i Madh, dita e parë Fitar Bajram, prvi dan	E mërkurë Sreda	10 prill 10 april	E mërkurë Sreda	10 prill 10 april
7.	Dita Ndërkombëtare e Punës Međunarodni Dan Rada	E mërkurë Sreda	01 maj 01 maj	E mërkurë Sreda	1 maj 1 maj
8.	Pashkët Ortodokse Pravoslavni Uskrs	E diel Nedelja	5 maj 5 maj	E hënë Ponedeljak	6 maj 6 maj
9.	Dita e Evropës Dan Evrope	E enjte Četvertak	9 maj 9 maj	E enjte Četvertak	9 maj 9 maj
10.	Bajrami i Vogël, dita e parë Kurban Bajram, prvi dan	E diel Nedelja	16 qershor 16 jun	E hënë Ponedeljak	17 qershor 17 jun
11.	Krishtlindjet Katolike Katolički Božić	E mërkurë Sreda	25 dhjetor 25 decembar	E mërkurë Sreda	25 dhjetor 25 decembar

Shënim: Data e festave zyrtare (bajrami/pashkët) mund të ndryshojnë sipas kalendarit hënor.
Ne rast se do te këtë ndryshime do te vheni ne dijeni me një njoftim te dyë.

Zapis: ***Datumi službenih praznika (bajram/uskars) mogu se promeniti prema lunarnom kalendaru U slučaju izmena bićete obavešteni jednim drugim saopštenje.***

Rrjedhimisht, ne kundërshtojmë fuqishëm veprimin e Autoritetit Kontraktues — Policia e Kosovës, pasi ky vendim është marrë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me ligjin, duke u bazuar në një interpretim të gabuar ose të paplotë të dispozitave që rregullojnë afatet ligjore, prandaj A.K. sipas legjislacionit në fuqi është dashur që të shqyrtoj kërkesën tonë për rishqyrtim dhe jo ta konsideroj atë si të jashtë afatshme.

Pretendimi 2
A.K. nuk ka vepruar ne perputhshmeri te plote me Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 pasi qe Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME te dosjes se tenderit ne fjale ka hartuar dhe publikuar specifikime teknike te cilat favorizojne nje operator ekonomik dhe diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Kjo dukuri vërehet qartë në Aneksin 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, pjesë e dosjes së tenderit, ku duke marrë parasysh edhe faktin që ky tender është duke u ri-tenderuar për më shumë se një herë edhe pse në titullin e dosjes aktuale të tenderit nuk është e cekur që kjo procedurë e prokurimit është ri-tender, A.K. nuk ka vepruar konfrom LPP-së dhe Rregullores për Prokurimin Publik (Rregullore Nr. 002/2024) dhe bie ndesh me të njejtat, specifikisht kjo pjesë e specifikimeve teknike "Pjesët kryesore të automjetit(motorri,shasia dhe kabina duhet të jenë nga i njëjti prodhues)." Që për të cilen kompania jone D&T Group SH.P.K. konsiderojme se kjo kërkesë e A.K. ne specifikimet teknike të dosjes se tenderit duhet të rishikohet dhe te

largohet nga specifikimi teknik për shkak të natyrës diskriminuese dhe kufizuese të saj, të cilat bien ndesh edhe me parimet e konkurrencës së drejtë dhe të hapur.

Kjo kerkese ne specifikimet teknike dëshmon se A.K. nuk ka vepruar konform LPP-së perkatesisht Neni -1 Qellimi, pasi qe specifikimet teknike nuk janë në përputhje me qëllimin e ligjit për të siguruar mënyrën më efikase, transparente dhe të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike. Për më tepër, kërkesat për pjesët kryesore nga i njëjti prodhues kufizojnë konkurrencën dhe rrisin koston e fondeve publike, në kundërshtim me këtë nen, dhe A.K. nuk ka siguruar që fondet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike dhe efikase siç parasheh Neni – 6 i LPP-se, duke imponuar kushte që kufizojnë konkurrencën dhe favorizojnë prodhues specifik.

A.K. me këtë kerkese të lartecekur për pjesët kryesore nga i njëjti prodhues diskriminon operatorët ekonomikë që mund të ofrojnë produkte Evropiane të cilat mund te dëshmohen me certifikatë CE, duke ulur konkurrencën dhe favorizuar një ose më shumë prodhues specifik, duke mos vepruar konfrom Neni 7 - Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, por ka përcaktuar kritere që nuk janë proporcionale dhe të nevojshme për përmbushjen e qëllimit të kontratës, duke përjashtuar operatorët që ofrojnë produkte të përputhshme dhe cilësore të brendeve të ndrryshme siç jane IVECO, MAN, RENAULT, FORD,OTOKAR, DAF, SCANIA, etj., të cilët përdorin komponent te firmave të ndrryshme si me poshtë:

Iveco Trucks
Motorri: Iveco Trucks
Shasia: Iveco Trucks
Boshti I shasise: Dana Spicer, Meritor
Kabina: Fiat Chrysler Automobiles
Transmisioni: ZF transmissions
Suspensioni: Hendrickson, SAF-Holland
Frenat: Knorr Bremse, WABCO
Sistemi elektronik: Bosch
Sistemi I ndriqimit: Hella, Magneti Marelli

MAN
Motorri: MAN
Shasia: MAN
Boshti I shasise: MAN
Kabina: MAN
Transmisioni: ZF Friedrichshafen
Suspensioni: SAF-Holland, Hendrickson
Frenat: Knorr-Bremse, WABCO
Sistemi elektronik: Bosch
Sistemi I ndriqimit: Hella, Valeo

Renault Trucks
Motorri: Volvo Group
Shasia: Renault Trucks
Boshti I shasise: Dana Spicer
Kabina: Renault Trucks
Transmisioni: Volvo Trucks
Suspensioni: Hendrickson

Frenat: Knorr-Bremse
Sistemi elektronik: Bosch, Continental
Sistemi I ndriqimit: Hella, Valeo

Ford Trucks
Motorri: Cummins
Shasia: Ford
Boshti I shasise: Dana Spicer
Kabina: Ford
Transmisioni: ZF Friedrichshafen
Suspensioni: Hendrickson
Frenat: WABCO
Sistemi elektronik: Bosch
Sistemi I ndriqimit: Magneti Marelli

DAF Trucks
Motorri: PACCAR (MX engines)
Shasia: DAF
Boshti I shasise: Dana Spicer
Kabina: DAF
Transmisioni: ZF Friedrichshafen
Suspensioni: Hendrickson, SAF-Holland
Frenat: Knorr-Bremse, WABCO
Sistemi elektronik: Continental, Bosch
Sistemi I ndriqimit: Magneti Marelli, Hella

Scania Trucks
Motorri: Scania
Shasia: Scania
Boshti I shasise: Scania
Kabina: Scania
Transmisioni: Scania
Suspensioni: Hendrickson, SAF-Holland
Frenat: Knorr-Bremse, WABCO
Sistemi elektronik: Continental, Bosch
Sistemi I ndriqimit: Magneti Marelli, Hella

KURSE
BRENDI I FAVORIZUAR
Mercedes Benz Trucks Atego 816
Motorri: Mercedes-Benz
Shasia: Mercedes-Benz
Boshti I shasise: Mercedes-Benz
Kabina: Mercedes-Benz
Transmisioni: Mercedes-Benz
Suspensioni: Mercedes-Benz
Frenat: Mercedes-Benz
Sistemi elektronik: Mercedes-Benz
Sistemi I ndriqimit: Mercedes-Benz
Fuqia e motorit : 160 PS

Certifikata CE është standardi i vetëm dhe i domosdoshëm që garanton përputhshmërinë e automjetit me të gjitha rregullat e sigurisë, shëndetit dhe mbrojtjes së mjedisit që kërkon Bashkimi Evropian. Kjo certifikatë vërteton në mënyrë të padiskutueshme që automjeti plotëson të gjitha kërkesat ligjore dhe teknike për përdorim në tregun evropian.

Kërkesa që motori, shasia dhe kabina të jenë nga i njëjti prodhues është e panevojshme dhe e dëmshme. Kjo kërkesë vetëm limiton konkurrencën dhe mundësinë për të siguruar produkte të cilësisë më të lartë. Automjetet moderne, sidomos ato komerciale, janë të ndërtuara me komponentë të ndryshëm nga prodhues të njohur dhe të specializuar. Kjo është një praktikë e zakonshme dhe e pranueshme në industrinë globale të automjeteve dhe nuk ndikon aspak në cilësinë dhe sigurinë e produktit përfundimtar.

Duke theksuar vetëm rëndësinë e certifikatës CE, është e qartë që ky është fakti i vetëm që duhet marrë parasysh për të vlerësuar përputhshmërinë e një automjeti me standardet e BE-së. Origjina e komponentëve individualë (motori, kabina, shasia) nuk ka asnjë ndikim të drejtpërdrejtë në përputhshmërinë me këto rregullore dhe është e paarsyeshme dhe e padrejtë të kërkohet që këto të vijnë nga i njëjti prodhues.

Prandaj, kërkesa për të pasur motorrin, shasinë dhe kabinën nga i njëjti prodhues duhet të largohet pasi ajo vetëm favorizon nje prodhues si Mercedes Benz Trucks, duke penguar konkurrencën e drejtë dhe duke kufizuar mundësitë për të ofruar një automjet që është më efikas dhe i përputhshëm me të gjitha standardet evropiane. Çdo prodhues i njohur ka automjete që përputhen me standardet CE, pavarësisht nga origjina e komponentëve të tyre. Kjo është ajo që duhet të konsiderohet si kërkesa kryesore për tenderimin dhe Certifikata CE është e vetmja që ka rëndësi dhe e vetmja që duhet kërkuar në proceset e tenderimit. Të gjitha kërkesat e tjera që kërkojnë një përputhje të ngushtë mes komponentëve janë të pasakta dhe të papranueshme në kuadër të standardeve të BE-së.

Vlen të permendet poashtu që në proceduren e prokurimit paraprake me nr. te prokurimit 214/23/018/111, per te njejtin furnizim nuk eshte kerkuar kjo kerkese specifike nga A.K.

Garancioni i autobartëses duhet të jetë garancion i plotë **24** muaj, në çmimin e autobartsesë duhet të përfshihen edhe servisimet e rregullta (vaji,filterat-set si dhe frenat) brenda periudhës garantuese. Autobartësja duhet të jetë e re me vit të prodhimit identik me vitin e urdhërblerjes. Kompania fituese është e obliguar që në momentin e nënshkrimit të kontratës të na furnizon me : "Paisje për diagnostifikim kompjuterik dhe CD (katalogun /programin) për pjesë rezerv)" për modelin e autobartses ne fjalë , po ashtu kompania fituse është e obliguar që të bëjë trajnimin e së paku dy mekanikëve të autoritetit kontraktues dhe të njejtit të pajisen me qertifikata. Obligative autobartësja duhet të jetë e me standard **Europian.**

dhe duke marrë parasysh qe Specifikimet teknike duhet të përshkruhen sipas standardeve ndërkombëtare dhe të bazohen në performancë ose funksionalitet. Referencat për prodhues të veçantë (p.sh., pjesët kryesore nga i njëjti prodhues) janë shkelje direkte Nenit 28 – te LPP-së dhe ka përcaktuar kritere që nuk janë proporcionale dhe të nevojshme për përmbushjen e qëllimit të kontratës, duke përjashtuar operatorët që ofrojnë produkte të përputhshme dhe cilësore, e poashtu kerkesat e A.K. duhet të bazohen në mosdiskriminim, transparencë dhe barazi. Vendosja e kritereve që favorizojnë prodhues specifik është në kundërshtim me këto parime.

Poashtu kemi kerkuar nga autoriteti kontraktues duke u thirrur në nenet e lartë përmendura, dhe ne pergjigjet e autoritetit kontraktues ndaj kërkesave për sqarim te dates 04.10.2023 per proceduren paraprake te prokurimit per furnizimin e njejtë te lejoje dhe harmonizoje ofertimin e autobarteses me 150hp.

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government Qeveria – Vlada – Government Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/ Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate	

SQARIMET SHTESË

Bashkangjitur gjeni pyetje dhe përgjigje për projektin "FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në –RITENDER 1 " me numër te prokurimit 214-23-9821-1-1-1; 214/23/018/111.

Pyetja 1

Te nderuar a pranohen keto kerkesa

1: Keni kerkuar Pesha Bartëse L min 3.5t , a pranohet Pësha Bartese : 2.7t .

2: A pranohet te vozitet Autobartesi prej prodhuesit deri ne Prishtine perafersisht :2000KM.

Përgjigje 1:

-Pesha bartëse nuk lejohet 2.7 t
-Autobartësje pranohet te vozitet prej prodhuesit deri ne Flotë afersisht 2000 km

Pyetja 2

Identifikimi i informacioneve shtesë ose i informacioneve sqaruese, përfshirë referimet në pjesën apo në pjesët e dosjes së tenderit:

1. *Është kërkuar minimum 160 PS, a është e tolerueshme nëse Autobartësja ka 150 PS ?*
2. *Transmisioni është kërkuar me 6 shpejtësi, a është e pranueshme me 5 shpejtësi?*

Përgjigje 1:

-Autobartesja lejohet edhe 150 PS
-Pranohet transmisioni edhe me 5 shpejtësi

Për më tepër mos-barazia në trajtim nga ana e A.K. mund të vërehet edhe në krahasimin e proces verbalit të hapjes së procedurës paraprake me nr.214-23-9821-1-1-1 për furnizimin

e njejtë kjo kërkesë specifike nuk ishte përfshire, ku ishin 5 oferta

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	214-23-9821-1-1-1	Titulli i Kontratës Contract Title Naziv ugovora	FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-RITENDER 1
Numri i brendshëm Internal No Interni broj			

Data e fillimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera
03.11.2023	03.11.2023, 14:00;00	03.11.2023, 14:00:00	Rr "Luan Haradinaj"- nr. 99 mërtesa e re e Administratës te Policisë, kati II, zyra e Prokurimit nr. 31, Prishtinë, Kosovë.	5

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Supplement/Amendment Dopuna/Izmjena
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Ideal Shala B.L.; BAAF SH.P.K. Parku i Biznesit Drenas, 13000, Drenas	214-23-9821-1-1-1	FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-RITENDER 1	PO	202337.29	238756.00	JO
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik AGS Corporation SH.P.K.; KOSOVA MOTORS GROUP S H.P.K. Dardania BL.1 Hy.3, 10000, PRISHTINË	03/11	FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-RITENDER 1	PO	224466.10	264870.00	JO
3.	N. P.T. " Hashijaha" Sh.p.k. Xhelal Hajda, 21010, RAHOVEC	03/11/23	FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-RITENDER 1	PO	200847.46	237000.00	JO
4.	PI ER TECHNICAL KR Branch in Kosovo, Rr. Ukshin Kovaçica nr.11, 10000, Prishtinë	PIER 3	FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-RITENDER 1	PO	205084.75	242000.00	JO
5.	"D & T Group" SH.P.K., Sadik Pozhega / p.n., 50000, GJAKOVË	15/2023	FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-RITENDER 1	PO	199152.54	235000.09	JO

Komisioni i hapjes / Opening commission / Komisija otvaranja

Emri Mbiemri Name Surname Ime Prezime	Nënshkrimi/ Signature/ Potpis	Data/ Date/ Datum
Hazbije Krasniqi		03/11/2023
Sabide Beqiri		03.11.2023

Nënshkrimi i Zyrtarit të Prokurimit/ Procurement Officer Signature/ Potpis službenika za javne nabavke:

Artan Fejza

për dallim me proces verbalin e hapjes së datës 30.12.2024 ku është vetëm një ofertë, pasi që pjesë e dosjes së tenderit janë vendosur specifikimet teknike e reja diskriminuese, çka dëshmon se A.K. ka ndryshuar praktikat në mënyrë të paarsyeshme dhe në kundërshtim me vetë parimet e LPP-së dhe Rregullores së Prokurimit Publik (Rregullore Nr. 002/2024).

Pretendimi 3

Duke konsideruar edhe faktin se për të njejtin furnizim të kërkuar nga A.K. në proceduren paraprake të prokurimit me nr. nr.214-23-9821-1-1-1, kompania jonë D&T Group

SH.P.K. është shpallur fituese e aktivititetit të prokurimit, perveç të tjerash duke pranuar edhe njoftimin për dhënie të kontratës. Pas pranimit të këtij njoftimi, rreth pesë muaj më vonë, Autoriteti Kontraktues anuloi procedurën e prokurimit, pa respektuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe kushtet e dosjes së tenderit dhe ne si kompani, kemi qenë të detyruar të dërgojmë këtë çështje në gjykatën kompetente për shkak të dëmeve të shkaktuara nga anulimi i padrejtë. Është e rëndësishme të përmendet se për furnizimin e njejtë në aktivitetin paraprak të prokurimit të lartëcekur në fillim të këtij pretendimi me nr 3, pas dërgimit të ankesës nga ana jonë në OSHP, ekspertja shqyrtuese Blerina Huruglica në Raportin e Ekspertit Shqyrtues me nr. të lëndës 2024/0466, ka kërkuar arsyetim dhe sqarim më të detajuar për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe përgjigjja e autoritetit kontraktues ndaj pyetjeve te Ekspertes Shqyrtuese ka qenë si më poshtë citoj: |*"Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës të dokumentuara në E-prokurim sqaron se, fillimisht është kërkuar arsyetim dhe sqarim më i detajuar nga AK, lidhur me arsyen dhe anulimin e aktivitetit të prokurimit, për faktin se nga data e njoftimit për dhënie dhe data e njoftimit për anulim është rreth pesë muaj. Sqarimi është se, të njëjtit kanë mbajtur një takim, ku është kërkuar opinioni i njohësve të fushës, të cilët kanë shpjeguar se "Auto bartësja nuk i plotëson kriteret konform kërkesës, sepse automjeti është i montuar nga kompania turke Otokar, ndërsa pjesët janë të prodhuesve të ndryshëm, kabina nga kompania FOTON, motori nga kompania amerikane CUMMINS dhe ndërruesi nga kompania gjermane ZF, dhe si e tillë konstatojnë se auto bartësja e ofruar nuk është sipas kërkesave dhe nevojave të flotës, ndërsa sa i përket specifikave të tjera teknike nuk kanë vërejtje"".* | Duke u bazuar në këtë fakt vërehet qartë se në proceduren e prokurimit aktuale të zhvilluar nga A.K. Policia e Kosovës është vendosur kërkesa e re diskriminuese "Pjesët kryesore të automjetit(motorri,shasia dhe kabina duhet të jenë nga i njëjti prodhues).", e cila nuk ka qenë pjesë e dosjes së tenderit së procedurës paraprake për furnizimin e njejtë por është pjesë e kësaj dosje të tenderit. Ky justifikim nga Autoriteti Kontraktues jo vetëm që është i pabazuar, por siç shihet gjithashtu ka rezultuar në ndryshimin e specifikimeve teknike në procedurën aktuale të prokurimit ku është vendosur një kërkesë diskriminuese dhe e pajustifikueshme. Sipas LPP-së, procedurat e prokurimit duhet të zhvillohen në menyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomik të interesuar për pjesëmarrje dhe të kenë kërkesa të arsyeshme nga A.K., e jo si kjo kërkesë e cila është plotësisht diskriminuese dhe nuk mund të arsyetohet nga ana A.K. përveq se si preferencë personale e njohësve të fushës apo njësisë kërkuese të A.K., pasi që kur një automjet është i certifikuar me certifikaten CE, kjo certifikatë garanton që çdo automjet që e ka këtë certifikate plotëson standardet e sigurisë, shëndetit dhe mbrojtjes së mjedisit, duke e bërë të përshtatshëm për përdorim në tregun evropian. Origjina e pjesëve individuale të automjetit (si motori, kabina dhe shasia) nuk ka asnjë ndikim në përmbushjen e standardeve teknike dhe nuk mund të përdoret si argument për vendosjen e kërkesave diskriminuese.

Duke u bazuar në pretendimet e parashtruara më sipër, ne, **D&T Group SH.P.K.**, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) të marrë si **vendim**:

1. **Të shpallë të pavlefshëm vendimin e Autoritetit Kontraktues (Policia e Kosovës)** mbi refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim si "të jashtë afatshme" dhe

të konstatojë se kërkesa jonë është dorëzuar brenda afatit të paraparë ligjor, duke marrë parasysh rregullat për kalkulimin e afateve kohore sipas LPP-së dhe nenit 5 të tij.

2. **Të anulojë procedurën aktuale të prokurimit me nr. 214-24-10564-1-1-1**, duke vërtetuar se specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues, si "Pjesët kryesore të automjetit (motori, shasia dhe kabina duhet të jenë nga i njëjti prodhues)", janë diskriminuese dhe në kundërshtim me parimet e drejtësisë, konkurrencës dhe barazisë të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik dhe aktet nënligjore përkatëse.

3. **Të urdhërojë rishikimin e dosjes së tenderit**, duke eliminuar çdo specifikim teknik diskriminues dhe duke siguruar që kërkesat teknike të bazohen vetëm në performancën dhe funksionalitetin e automjetit, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e Bashkimit Europian, siç garanton certifikata CE.

4. **Të sigurojë që të gjitha procedurat e ardhshme të prokurimit për furnizimin e automjeteve të zhvillohen në mënyrë transparente, të drejtë dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë,** duke respektuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregulloren për Prokurimin Publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

D&T Group SH.P.K. konsideron se kjo mënyrë e zhvillimit të aktivitetit të prokurimit dëmton rëndë kompaninë tonë, e cila gëzon një përvojë shumëvjeçare dhe reputacion të konsoliduar në fushën e furnizimit. Ky proces i padrejtë dhe diskriminues na ka penguar në ushtrimin e aktivitetit tonë ekonomik, për të cilin kemi bërë investime të konsiderueshme, përfshirë trajnimin e stafit dhe përgatitjen profesionale për të përmbushur kërkesat e tregut. Përveç dëmeve të drejtpërdrejta financiare dhe morale, rrezikohet rëndë edhe imazhi ynë si operator ekonomik i besueshëm dhe konkurrues. Gjithashtu, një menaxhim i tillë joefikas dhe diskriminues i prokurimeve publike mund të shkaktojë pasoja të dëmshme për buxhetin e shtetit, duke ndikuar negativisht në përdorimin efikas të fondeve publike

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*